



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 19.12.2011, në orën 14:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Blerta Deliu – Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Sasha Milosavljeviq dhe Fatmir Limaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Logja, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Nexhat Shatri – zyra e Presidencës, Lejla Selimi – OSBE, Dritro Arifi – MIE, Besnik Ramadani – KDI dhe Venera Mjekiqi – KIE.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 13.12.2011;**
- 3. Miratimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011;**
- 4. Miratimi i Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për Policinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Takimi me prof. dr. Ludger Kuhnhard, ekspert gjerman për integritet evropian;**
- 8. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 13.12.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 13.12.2011, pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2011

Kryetari - Tha se ky është raporti i dytë dhe i fundit për këtë plan të veprimit për këtë vit, mbetet të plotësohet edhe me ligjet të cilat do të miratohen këto ditë dhe të procedohet për miratim në seancë plenare. Në emër të komisionit do ta paraqes në seancë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Miratimin e Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2011.

4. Miratimi i Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2012

Kryetari- -Njoftoi për propozimin për formimin e një këshilli nacional për integritet evropian, ku Kuvendi i Kosovës do të ketë rolin e tij. Për Planin e Veprimit nuk është paraparë buxhet shtesë.

Alma Lama – Tha se krijimi i një këshilli të tillë është i panevojshëm, sepse po krijohen shpenzime buxhetore.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Miratimi i Planit të Veprimit për Kuvendin e Kosovës për Integrim Evropian për vitin 2012 dhe procedimin për miratim në seancën plenare të radhës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari, tha se nuk ka vërejtje sa i përket këtij Projektligji.

Albert Kinolli – Tha se është arritur marrëveshje sa i përket Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Vjosa Osmani – U shpreh se ky buxhet nuk garanton qëndrueshmëri financiare për këtë vit.

Alma Lama – Ky Projektligj ka mungesë të qëndrueshmërisë financiare.

Kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota për dhe dy kundër nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire dhe mund të procedohet për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për Policinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së

Kryetari ftoi deputeten Blerta Deliu – Kodra referuese e këtij Projektligji.

Blerta Deliu – Kodra – Pas shqyrtimit, konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Policinë me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Takimi me prof. dr. Ludger Kuhnhard, ekspert gjerman për integritet evropiane.

Lutfi Haziri – E falënderoj z. Lüdger Kühnhard, ekspert gjerman për integritet evropiane dhe i shprehi mirëseardhje në takim me Komisionin për Integritet Evropiane. Ai tha se është një ditë shumë e rëndësishme për Kosovën pasi që sot zonja Merkel – Kancelare e Gjermanisë, e viziton Kosovën, pra është një kapitull i ri i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. I nderuari profesor, unë jam kryetar i Komisionit dhe jam nga opozita, nga partia e dytë e madhe, në anën time të djathtë është z. Xhavit Haliti, nënkryetari i parë i Komisionit dhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, nga partia në pushtet PDK, pastaj zonja Osmani nga LDK, pastaj zoti Blerim Shala, zëvendëskryetar i parë i AAK- së dhe partia e tretë në opozitë në parlament, Albert Kinolli është udhëheqës i partisë rome në parlament. Kurse anën time të majtë është zonja Blerta Deliu nga PDK, pastaj zonja Alma Lama nga Vetëvendosja, parti e opozitës dhe e fundit zonja Suzana Novoberdali, nga partia Aleanca Kosova e Re, e cila është deputete për herë të dytë.

Lüdger Kühnhard – Zoti kryesues Haziri, ju falënderoj shumë për mikpritjen e ngrohët dhe po ashtu është privilegj për mua të jemi në mesin tuaj në këtë komision, i cili është shumë i rëndësishëm në parlamentin tuaj. Ne kemi arritur sot këtu dhe mund të themi se sot ishte një ditë gjermane, pra një ditë e rëndësishme.

Tragjedia e cila ka ndodhur në luftën e Kosovës mund të arsyetohet para historisë dhe para gjitha principeve morale dhe në gjithë besimin në Zot, pra kjo ishte udhëheqja e Kosovës drejt pavarësisht të vet. Ai tha se unë kam qenë disa herë në Kosovës, në dymbëdhjetë vitet e fundit në cilësi të akademikut duke takuar koleg të ndryshëm. Në atë kohë kemi qenë të angazhuar në Paktin e Stabilitetit për përmirësimin e gjendjes në fushën e arsimit, por asnjëherë nuk kam pasur privilegjin të jem pranë një komisioni sikurse sot! Me shumë modesti e them se jam

shumë mirënjohjes me faktin që jam sot para jush. Ne jemi duke ardhur në disa momente shumë kritike të integritimeve në Bashkimin Evropian. Për një kohë të gjatë arsye kryesore për integritim në Bashkimin Evropian ka qenë që të krijohet paqja dhe stabiliteti i Evropës pas dy luftërave Botërore. Mirëpo kjo arsye shites për proceset e integritimit evropian ka ardhur në fundin e vet, kryesisht në sytë e shumicës së qytetarëve të BE-së, të cilët kanë lindur pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo se çfarë shohim në ditët e sotme lidhur me borxhet e shteteve sovranë dhe me fatin e euros, i tërë ky proces udhëhiqet nga një arsye tjetër.

Në kuptim të rregullit global zhvillimet e tanishme shkojnë në drejtim të rregullimit të pozitës së BE- së në këtë proces, 37% të rezervave në valuta sot në botë i takojnë euros, dhe stabiliteti i saj nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e zhvillimeve financiare dhe ekonomike, por gjithashtu duhet shikuar në balancat globale të fuqive. Ky debat se si të merremi me çështjen e euros dhe si të stabilizojmë euron dhe krizën brenda shteteve anëtare. Ky diskutim më shumë se kurrë është i ndërlidhur me qasjen që kanë qytetarët e BE- së lidhur me zhvillimet politike në BE.

Mendoj se prezenca sot, e sa i përket Kancelares znj. Angela Merkel, edhe pse me të nuk kam pasur asnjë aranzhim që të jemi më të njëjtën ditë këtu, ajo ka arritur që së bashku me Presidentin francez Sarkozy një marrëveshje të re për rregullimin e tregut financiar. Ky është vetëm një hap dhe mendoj që para vetes kemi një rrugëtim shumë të gjatë dhe të komplikuar. Të gjitha këto angazhime të liderëve të BE- së do të kenë sukses vetëm nëse qytetarët e BE-së do të mbështesin këtë proces. Në ditët e sotme arsye në integritimet evropiane është promovimi i besimit brenda njeri- tjetrit, brenda shteteve anëtare të BE-së, dhe tashmë kjo është një sfidë fundamentale shumë e rëndësishme në krahasim me të kaluarën kur cak ishte që të sillej paqja dhe stabiliteti brenda BE- së. Ministri i Punëve të Jashtme të Polonisë, zotëri Sikorski e ka definuar çështjen e politikës së jashtme për mendimin tim. Ai ka propozuar se caku përfundimtar i gjithë këtij procesi nëpër të cilin po kalojmë tani gjithë ne do të ishte projekti përfundimtar më i duhur, krijimi i një “federatë evropiane”. Unë personalisht e mbështes shumë këtë vizion, por e dimë që do të jetë jashtëzakonisht i vështirë në dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme.

Nëse e shikojmë historinë e zhvillimeve të proceseve integruese të BE-së, që nga viti 1957, mund të identifikojmë disa raste të krizave jo të integritimit me BE-në, por të proceseve integruese përbrenda vetë BE-së. Për mendimin tim kjo krizë me të cilën po ballafaqohemi sot është krizë e integritimit të brendshëm, pra përbrenda BE-së. Megjithatë mbetet të jetë një problem shumë i vështirë për shkak të këtyre dy parametrave të cilat sapo i kam përshkruar. Pra që ta forcojmë rolin e BE-së në fushën globale dhe që ta gjejmë legjitimitetin politik brenda qytetarëve për tërë këtë proces në të cilin po kalojmë. Sa i përket çështjeve përbrenda BE-së ne do t’ia dalim me këtë sfidë, vetëm nëse brenda shoqërive tona gjejmë mbështetjen e duhur për këto procese të integritimit në Bashkimin Evropian. Prandaj mund të themi se integritimi në BE për veç që është i karakterit politik, po ashtu është edhe një projekt të cilin mund ta quajmë me karakter shoqëror.

Që nga pavarësimi i Kosovës me shumë vëmendje i kam ndjekur zhvillimet këtu, dhe duhet të përmendim se ka pasur zhvillime progresive, e veçanërisht udhëheqja e këtij komisioni nga opozita. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian na sjell gjithmonë informacione të detajuara dhe mangësitë të cilat duhet të plotësohen dhe të tejkalohen. Ju i njihni më mirë se unë anët e dobëta dhe anët e forta të shtetit tuaj, mirëpo mendoj që është koha që të kemi një këndvështrim të ri të procesit të integritimeve evropiane, sa i përket raporteve Kosovë – BE, si nga qytetarët e BE- së ashtu edhe nga qytetarët e Kosovës. Për një kohë të gjatë ju do të kishit mundësinë për ta gjetur mbështetjen nga shumica e shteteve anëtare të BE-së, se zgjerimi i BE-së drejt Ballkanit Perëndimor është i mirëseardhur pasi që projekton stabilitetin tonë të BE-së drejt fqinjëve. Diplomatet sigurisht do t’ju thonë se ende është kjo perspektiva e drejtë. Miqtë e Kosovës dhe politikanët që do të vijnë t’ju vizitojnë sigurisht se do t’ju thonë të njëjtë gjë. Unë personalisht ende besoj në këtë, por si analist akademik më duhet t’ju them që të jem shumë i

sinqertë me ju, se ideja e projektimit të stabilitetit të BE- së drejt fqinjëve të vet në Ballkanin Perëndimor nuk është më në listën e përparësive të qytetarëve të BE-së. Natyrisht që ata e duan një gjë të tillë, pra e duan stabilitetin dhe evropianizimin e Ballkanit Perëndimor, por prioriteti i tyre tani për tani është stabiliteti i euros, dhe tani për tani kjo është pyetja numër një sa i përket çështjes së sigurisë.

Çfarëdo pyetje, me që lidhet me çështjen e zgjerimit, për shumë kënd kjo është mënyrë e prodhimit të më shumë problemeve se sa e zgjidhjeve të tyre. Unë përsëri ju them se kjo nuk është bindja ime, por këtu raportoj para jush se kjo është ajo çfarë dëgjoj për çdo ditë. Ekziston një hendek sa i përket kësaj çështje për shkak të zhvillimeve aktuale në BE në mes të pritjeve të shumë qytetarëve të shteteve anëtare të BE-së për stabilitetin, solidaritetin, stabilitetin e valutës euro, stabilitetin e vendit të tyre të punës, dhe dobritë e mundshme sa i përket zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor ose drejt Turqisë. Në këndvështrimin tim kjo gjendje është për keqardhje, por megjithatë kjo mbetet të jetë një përshkrim shumë i sinqertë i ndjenjave të qytetarëve të shteteve anëtare të BE-së në këto ditët e sotme. Prandaj mendoj se çështja është shumë më e komplikuar në ditët e sotme, apo të diskutojmë çështjen e hyrjes në BE në kuptimin bardh e zi, se a do të hyjmë sot, nesër, pasnesër, ose po ose jo. Çfarë do që të jetë e nevojshme që të bëhet në shtetin tuaj që të përafroheni me normat e BE-së, natyrisht se është shumë e rëndësishme. Po ashtu është e rëndësishme se zyrtarët e BE-së të cilët janë zotuar drejt shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe ata duhet ti përmbahen kësaj dhe kjo është më rëndësi, megjithatë mendoj se kjo është e rëndësishme, por jo edhe e mjaftueshme. Mendoj se kurrë më shumë duhet të shikojmë në potencialin e shoqërive tona që të afrohen drejt njëra- tjetrës. Nëse nuk e kemi para vetes të qartë dhe nëse nuk e dimë një orar një afat kohor të karakterit politik, nuk mund të presim shumë nga shkëmbimet në mes të studentëve, në mes të artistëve, në mes punëtorëve dhe unioneve të ndryshme dhe sindikatave të punëtorëve. Gjatë këtyre viteve të vështira konsideroj se duhet të mendojmë për mënyra të reja se si t'i përafrojmë shoqëritë tona në mënyra tjera, kjo është një sfidë për të gjitha shoqëritë brenda shteteve anëtare të BE-së, dhe po ashtu edhe për Kosovën. Këtë pasdite dëshiroj që pas vetës të lë këtë mendim pranë jush, pasi që siç thonë njerëzit religjioz: “se ka jetë pas vdekjes”, e unë them “se ka jetë edhe pas borxhit”. Për momentin është shumë me rëndësi që ne mos të humbim njeri- tjetrin për shkak të këtyre angazhimeve të cilat kanë theks të veçantë përbrenda zhvillimeve të BE-së. Shumë njerëz flasin për një lodhje nga zgjerimi brenda BE-së, prandaj edhe kjo është çështja të cilën u mundova të përshkruaj dhe të shohim dhe të propozoj atë se çfarë mund të bënim dhe ta ndalojmë që kjo të mos ndodhë. Dhe nëse me lejoni kisha dashur të përfundoj më shumë me një theks politik. Në këndvështrimin tim sa ka qenë e rëndësishme gjatë viteve 1988-89, kur në vendin tim kishte rënë Muri i Berlinit dhe mendimi ishte se të gjithë do të jetojmë në paqe dhe të lirë brenda unionit ose bashkimit që mund të shohim, në një bashkësi e cila i bashkon të gjithë popujt e Evropës. Në një bashkim ku të gjithë kufijtë ekzistues do të respektoheshin nga të gjithë fqinjët dhe do të jetonim në një union ku njerëzit nga vendet e ndryshme dhe kulturat e ndryshme do të kishin respekt ndaj njëri- tjetrit. Por më e rëndësishmja në këtë proces që të arrijmë këtë cak madhor është që Kosova të jetë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian. Objektivi është që mos ta humbin besimin e gjeneratave të reja dhe fati i gjeneratave të reja është në Bashkimin Evropian. Kjo është një sfidë edhe për vetë BE- në, po ashtu është edhe për Kosovën dhe kjo sfidë si e tillë neve na bashkon madje edhe para hyrjes formale të Kosovës në BE. Ai tha se kam besim në ju dhe liderët tuaj se do të punoni që shpresa dhe optimizmi dhe perspektiva drejtë integritimeve brenda Bashkimit Evropian dhe hyrjes në vetë Bashkimin Evropian nuk do të humbet në mesin e të rinjve tuaj.

Lutfi Haziri – Ju falënderoj profesor për fjalën tuaj hyrëse, dhe faleminderit për vlerësimin, të cilin ia bëni rolit të Komisionit, meqë ne jemi njëri nga katër komisionet e përhershme. Dhe, siç e përmendëm, pas Stefan Fyles në Bruksel, muajin e kaluar, ju jeni i dyti që këtu e vlerësoni edhe rolin e opozitës, meqë në Ballkanin Perëndimor, Kosova është i vetmi shtet, në të cilin opozita dhe pozita janë së bashku në agjendën evropiane. Aspiratat e të dyja palëve në rajon,

janë të njëjta, mirëpo opozita, në të gjitha shtetet, u kundërvihet partive në pushtet. Ne punojmë së bashku, meqë besojmë në rrugën evropiane, dhe do të vazhdojmë të punojmë aq sa mundemi. Ne jemi nën shkronjat “D” këtu. Integrimi në Kosovë nuk fillon me “I”, sepse ne këtu kemi mjete të veçanta në raport me Brukselin: dialogu i Stabilizim-Asocimit, dialogu për liberalizimin e vizave dhe dialogu për sundimin e ligjit, nën kushtin e dialogut teknik me Serbinë. Dhe pastaj, natyrisht, i tërë Ballkani Perëndimor është më i vogël se Rumania sot, sa i përket territorit dhe numrit të banorëve dhe i tërë Ballkani Perëndimor nuk ka më shumë probleme se Rumania sot në kuadër të BE-së, si shtet me anëtarësi të plotë në BE. Por ne, prapëseprapë jemi këtu me aspiratat tona, në rrugën njëdrejtimëshe duke u përpjekur për ta bërë më të mirën.

T’ua japim fjalën kolegëve të mi të nderuar, nëse dëshirojnë të komentojnë ose të shtojnë diçka, ndërsa unë edhe një herë ju falënderoj që keni ardhur sot, dhe me padurim presim që të vijmë në bibliotekë dhe t’ju dëgjojmë edhe një herë.

Blerim Shala – Tha se është padyshim nder për ne, që të jemi sot së bashku me ju dhe të diskutojmë në vija të trasha raportet e Bashkimit evropian dhe Kosovës. Duhet të theksojmë atë që ju me siguri e dini, se integrimi evropian nuk është vetëm projekt politik dhe ekonomik, por ai është një lloj projekti i civilizimit për shqiptarët, dhe përgjithësisht për kosovarët këtu. Kjo patjetër do të konfirmojë se ne jemi pjesë e perëndimit, në perspektivën afatgjatë. Ne, pak a shumë e dimë se çka do të ndodhë me ne pas 10- 12 vitesh, por askush nuk e di se çfarë do të ndodhë gjatë 10-12 muajve në vijim, me ne dhe në raport me të qenurit tonë në BE. Kosova është vërtet shumë specifike për Bashkimin Evropian. Jo vetëm pse euro është valuta jonë zyrtare, por edhe për faktin se EULEX-i është i pranishëm këtu si mision i sundimit të ligjit. Ndërsa, Kosova siç e dini, sipas konkluzionit përfundimtar të takimit të Këshillit të Ministrave të vitit 2007, konsiderohet si prioritet numër një i Evropës. Ai ka qenë një shans tjetër, ose ende është një shans tjetër për Evropën, siç ka qenë në deklaratën e famshme të Zhaklyt në vitin 1991, kur ka ndodhur shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Pra, ekzistojë disa pyetje, por e para është: a sheh Evropa ndonjë perspektivë në Kosovë, duke pasur parasysh atë që është thënë viteve të fundit, meqë shkalla e besimit tonë në BE nuk është e njëjta me atë që ka qenë disa vite më parë? Kjo është pa dyshim, shumë e rëndësishme, si dhe ajo që ne si Kosovë, përveç telasheve që i shkaktojmë BE-së, se ne jemi shumë të zotët për t’i shkaktuar telashe BE-së duhet të bëjmë që ta kemi vëmendjen e Brukselit dhe të tregojmë se Kosova është e rëndësishme. Sepse, duket se nga ky mësim ende nuk është mësuar fakti se Kosova është shumë e rëndësishme dhe se stabiliteti rajonal është shumë i vlefshëm për Evropën. Veç kësaj, ju keni absolutisht të drejtë kur thoni se stabiliteti i euros është tejet i rëndësishëm edhe për ne, meqë euro është pjesë e Kosovës.

Alma Lama – Tha se ne i çmojmë shumë lart pikëpamjet tuaja dhe natyrisht gjuhën, që është më shumë se politike dhe diplomatike. Ne, natyrisht që me shumë kujdes e përcjellim dhe jemi të preokupuar me atë që këto ditë po ndodh në BE, sepse kjo me- doemos ka të bëjë edhe me të ardhmen tonë, edhe pse Kosova është mjaft larg nga BE-ja për shkaqe politike dhe ndonjëherë unë personalisht tallem kur them se kur ne do të jemi gati të hyjmë në BE, BE-ja nuk do të ekzistojë më (BE-ja si Bashkim). Por natyrisht, ne besojmë se kjo situatë do të tejkalohet dhe se Evropa do të jetë më e efektshme në çështjen e Kosovës, sepse shumë prej çështjeve janë të natyrës politike dhe gjithçka ndërlidhet me zhvillimet evropiane dhe ne shpresojmë se situata do të përmirësohet dhe do të vijë një e ardhme më e mirë.

Vjosa Osmani – Dëshiroj t’i bëj disa komente të shkurtra, e pastaj të marrë mendimin tuaj të mëtejshëm për rolin e rinisë dhe për besimin të cilin rinia e ka në perspektivën evropiane. Unë besoj se edhe nëse ky nuk do të kishte qenë rasti i ndonjë shteti tjetër në Evropë, ky është pa dyshim rasti i Kosovës tonë, duke qenë shteti me popullsinë më të re në Evropë, me më shumë se 60% të popullsisë nën moshën 30 vjeçare. Problemi qëndron tek të rinjtë, sepse unë me ta punoj çdo ditë. Dhe jo në kuptimin e asaj që të rinjtë e kanë shtjelluar sot këtu, ose të asaj që unë mund t’ju shpjegoj atyre nga këndvështrimi i profesorit. Ata nuk mendojnë medoemos për stabilitetin e Euros, e as që mendojnë për atë se çka po ndodh ndërmjet Merkel dhe Sarkozy.

Këndvështrimet dhe mendimet e tyre janë të natyrës praktike, se sa janë ata të lirë të udhëtojnë në Evropë, sa janë ata të lirë t'i shkëmbejnë njohuritë e tyre, idetë e tyre, dhe t'i shkëmbejnë ato me bashkëmoshatarët e tyre. Unë besoj se ky ka qenë një komponent kyç dhe çështja, të cilën z. Shala e përmendi, lidhur me nivelin e lobimit në Evropë për pesë vitet e fundit, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se Kosova është lënë vendi i vetëm në rajon që nuk është përfshirë në procesin e liberalizimit të vizave. Kur ne flasim për njerëzit e zakonshëm, ata nuk mendojnë për politikë dhe për mënyrën në të cilën jetët e tyre do të ndikohen drejtpërsëdrejti nga kjo politikë, ata nuk çajnë kokën se për çka bisedojnë Merkel dhe Sarkozy, ata preokupohen vetëm se si do ta marrin vizën, qoftë për qëllime private ose për ato të punës. Pra, dëshiroj mendimin tuaj ose komentin tuaj, që është në rregull për mua, por ky është preokupimi im për gjendjen aktuale ose për Kosovën në veçanti, e posaçërisht kur bëhet fjalë për të rinjtë. Ky preokupim nuk ndërlidhet drejtpërsëdrejti me një politikë më të madhe, më të lartë ose më të rëndësishme dhe me politikat e BE-së, por me politikën e veçantë të BE-së ndaj Kosovës, që ka të bëjë me jetën e përditshme të kosovarëve dhe që drejtpërsëdrejti ndërlidhet me procesin e liberalizimit të vizave.

Lutfi Haziri – Tha se dëshiron që për Vjosën t'i shtojë disa shifra, sepse ajo është profesoreshë në Fakultetin e Drejtësisë, aty punon shumë me studentët. Vitin e kaluar është bërë një hulumtim, nga i cili është konstatuar se 92 % të të rinjve nga mosha 16 deri 26 vjeç, kurrë nuk kanë udhëtuar më larg se në Shkup ose në Tiranë. Gjenerata e re e shikon Gjermaninë nëpërmjet ekipeve të futbollit, për ta është Bajerni ose ndonjë ekip tjetër i futbollit, dhe çdo gjë në lidhje me Gjermaninë është futbollit, nuk është diçka në të cilën ata vërtet besojnë. Ata do të dëshironin të kishin mundësi të një shkollimi më cilësor, të studiojnë ose të mbarojnë për master, ose të ngjashme. Por këtu qëndron problemi kryesor. Ata të gjitha lidhjet dhe informimin që marrin i bëjnë nëpërmjet televizionit ose filmave që i shohin. Nga ana tjetër, të jemi realistë, këtu kemi më shumë se 300.000 folës të gjermanishtes, nga numri i përgjithshëm prej 2 milionëve ose 300.000 njerëz që janë familjarizuar me jetën në Gjermani, Zvicër ose Austri, gjenerata e parë dhe e dytë e të cilëve ende jetojnë atje dhe shumë shpejt edhe gjenerata e tretë do të fillojë të jetojë atje.

Sot është vënë edhe një kusht tjetër, jo vetëm ndaj Serbisë, që të përfitojë nga mundësia për të marrë statusin e kandidatit. Ne nuk jemi kundër tyre, kundër aspiratave të Serbisë, por ne kemi aspiratat tona drejt integritimit në Evropë. Ata janë bërë peng për neve, serbët janë bërë peng edhe i aspiratave tona.

Blerta Deliu-Kodra – Profesori tha se është i informuar për situatën në Kosovës prej kohës së paraluftës, po ashtu tha se këtë proces nuk duhet parë vetëm bardh dhe zi, kjo më bëri përshtypje dhe po ndërlidhem me atë që tha Vjosa, sepse qytetarët na pyesin për çdo ditë se kur do të jetë dita kur do të bëhet liberalizimi i vizave, ata kanë dëshirë që të udhëtojnë lirshëm në vende të ndryshme të Evropës. Po e përmendi këtë, sepse edhe ne si deputetë po kemi telash në marrjen e një vize, e lëre më qytetarët e thjeshtë. Nga profesori u përmend edhe puna e mirë që ka bërë pozita dhe opozita në këtë proces, por unë dua ta pyes se, a mendon se Kosovës iu kanë bërë kriteret të dyfishta sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave.

Albert Kinolli – E përshëndes profesorin për vizitën dhe përkrahjen.

Shpresoj se kjo mbështetje për komunitetin rom do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Sa u përket vërejtjeve në Raportin e Progresin, e që ndërlidhet me gjendjen e komunitetit rom në Kosovë, ne kemi pasur rastin t'i vizitojmë disa shtete të Evropës, dhe siç ka thënë edhe kryetari ynë, që është përfaqësues i komunitetit rom dhe dihet që në shtetin tuaj ka me mijëra romë, dua të ndërlidhem me çështjen e riatdhesimit. Unë në mënyrë të sigurtë them se komunitetet pakicë, duke përfshirë edhe komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas dhe komunitetet tjera, janë shumë më mirë se në vendet e rajonit dhe të Evropës, pra gëzojnë të gjitha të drejtat. Sa i përket komunitetit rom, që nuk ndodh në vendet e rajonit dhe të Evropës, ka subjektin e vet politik, përfaqësuesit legjitim në institucionet më të larta të shtetit, duke përfshirë edhe

Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne jemi përfshirë në të gjitha proceset që ka kaluar Kosova, si në atë lokal dhe atë qendror. Pra i gëzojmë të gjitha të drejtat si komunitetet tjera, po ashtu dhe komuniteti shumicë. Duke pasur parasysh këto fakte si deputet i Kuvendit të Kosovës, në tërësi nuk e përkrahi Raportin e Progresit në lidhje me komunitetet pakicë. Nuk e di nëse profesori ka qenë i informuar për këtë dhe dua ta di mendimin e tij.

Lüdger Kühnhard – Ju falënderoj shumë për këto informata të hapura dhe për këtë shkëmbim përvojash, që për mua janë shumë të vlefshme dhe të dobishme. Unë gjithmonë jam i prirë të mendoj se ekzistojnë dy mënyra në të cilat mund të shikohet Evropa. Njëra prej tyre është që Evropën, si kontinentin tonë të përbashkët, ta shikojmë nga perspektiva e kufizimeve, sa i përket mënyrës se si e organizojmë jetën tonë ose që Evropa të shikohet nga këndvështrimi i mundësive që ofron ajo. Njëra prej tragjediave të ngjarjeve si pasojë e luftërave që kanë çuar deri te shpërbërja e Jugosllavisë, ka qenë pa dyshim fakti se efektet e kësaj mënyre të menduarit, si dhe kategoritë e kufizimeve në rritje, duke përfshirë shumë pjesë të BE-së. Kur lufta ndodhi në Berlin, në vitet 1989-90, ideja ka qenë që për Evropën të mendohej në aspektin e kategorive të mundësive, të hapeshin muret, të hapeshin kufijtë, e jo të zbatoheshin standarde të reja, lëre më standardet e dyfishta, me qëllim të parandalimit të ndërveprimit dhe lëvizjes së njerëzve. Konsideroj se pasojat më të rënda, pasojat afatgjata të luftërave në Jugosllavi bien mbi të rinjtë, të cilët nuk kanë qenë përgjegjës nga cilado palë qofshin, pra janë ata që i vuajnë pasojat e të gjitha këtyre regjimeve për viza. Fakti se gjithë kësaj i shtohen standardet e dyfishta, e bën gjendjen edhe më të mjerueshme, por nëse më pyetni mua, standardi i dyfishtë për çështjen e vizave është vetëm një pasqyrim tjetër i standardeve të dyfishta për sovranitetin kombëtar që i kemi zhvilluar në botë. Sovraniteti i Kosovës është njëri prej standardeve të dyfishta. Sovraniteti juaj është një sovranitet i kontrolluar, që dallon nga sovraniteti i cilitdo shtet tjetër në botë, duke filluar nga Timori Lindor, Gjermania e Bashkuar, Bolivia e deri te cilitdo shtet tjetër i rruzullit tokësor. Kjo mendoj unë, është absolutisht e papranueshme, nëse i zbatojmë parimet universale të së drejtës ndërkombëtare ose të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën e lirisë së njerëzve, mirëpo për fat të keq, gjendja është kjo që është. Ju gjithmonë do të më keni në anën tuaj kur duhet të kërkohet njohja e gjithanshme dhe e plotë e Kosovës, si një shtet i zakonshëm, normal e i pavarur, si çdo shtet tjetër i botës. Si pasojë e kësaj situate, për fat të keq, kemi shumë standarde të dyfishta, përfshirë edhe atë për regjimin e vizave. Mirëpo, unë mendoj se ajo që më bën përshtypje nuk ka edhe aq të bëjë me kundërshtimet ligjore dhe standardet e dyfishta, ajo që mua vërtet më brengos është efekti në rininë, në vizionin dhe në pikëpamjet e tyre. Kjo është një situatë, të cilën ju e ndani madje edhe me shtetin që i paraqet më së shumti probleme pavarësisë së plotë të Kosovës – me Serbinë. Disa javë më parë, e kam vizituar Universitetin e Beogradit dhe disa profesorë atje më kanë thënë se sot, politika e BE-së e zgjat edhe më shumë tunelin sa herë që njerëzit e shohin dritën në fundin e tij, se ata (nga BE-ja) dalin me kushte dhe argumente të reja, megjithëse u bë liberalizimi i vizave së fundi, por që për këtë njerëzit kanë pritur tepër shumë, posaçërisht të rinjtë, të cilët kurrë nuk kanë qenë pjesë e saj (BE-së).

Kolegët në Beograd më kanë thënë se sot nacionalizmi tek 20-vjeçarët serbë është më i lartë se ai gjatë kohës së Millosheviqit. Ky nacionalizëm nuk është kundër jush, por kundër BE-së, për shkak të frustrimeve të tjera dhe kjo për mua është shokuese, e tmerrshme dhe shumë e keqe, ndërsa faji është gabimi i BE-së të cilët fqinjët i vështrojnë nga perspektiva, si mund ta mbrojmë veten, si mund ta ndalojmë ardhjen e njerëzve nga vendet ballkanike etj. Ju mund të më konsideroni plotësisht në anën tuaj, meqë unë e dënoj këtë dhe flas kundër këtij trendi, dhe së këndejmi shpresoj se negociatat për liberalizimin e vizave që do të fillojnë në janar, pas disa javësh, do të sjellin një zgjidhje të shpejtë të kësaj krize. Shpresoj për këtë edhe pse unë nuk do të ulem pranë tavolinës, këtë nuk do ta bëj as përfaqësuesi i Ambasadës Gjermane këtu, por kjo do të negociohet në Bruksel dhe shpresoj që rezultatet e këtyre negociatave do të hapin rrugë të reja dhe ardhmëri evropiane, veçmas për njerëzit e rinj, për studentët ose për njerëzit e të gjitha profesioneve nga të gjitha aspektet e jetës. Problemi, siç kam folur më parë dhe siç mund ta

dini, nuk është te Brukseli, te burokratët, te diplomatët, te politikanët, por te atmosfera e gjithmbarshme që është krijuar në shoqëritë tona, sipas së cilës, Ballkani Perëndimor perceptohet si vend prej nga ushqehet e keqja dhe buron krimi i organizuar, sipas së cilës Ballkani Perëndimor prodhon më shumë probleme dhe i eksporton ato në vend që të prodhojë mallra të konsumit të përbashkët. Ky është një perceptim i gabuar, por që për fat të keq dominon në shumë vende të BE-së. Si pasojë, ne të gjithë shohim kufizime të vizave, jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe ndaj të tjerëve dhe kjo është shumë tragjike, sepse gjithë mundin që e bëjmë, tërë kapitalin njerëzor që e investojmë për ta penguar Kosovën të bëhet shtet i zakonshëm evropian, do të kishte qenë më mirë të investonim në ofrimin e një perspektive më të ndritshme për rininë dhe për ju. Pra, unë jam plotësisht në anën tuaj, por unë mendoj që kjo anomali e strukturës së pavarësisë së kontrolluar që nuk është e bazuar, që nuk është e pranueshme dhe nuk është e drejtë, nuk do të jetë e përshtatshme për të qenë në rrugën drejt së ardhmes. Unë mendoj se është e domosdoshme të bëhen përpjekje maksimale që të arrihet anëtarësimi i Kosovës në çdo kontekst të mundshëm funksional, që ndihmon ndërtimin e urave për lidhjen me pjesën tjetër të Evropës, anëtarësimi në futbollin evropian ose në aktivitete tjera sportive, anëtarësimi në lojërat olimpike, anëtarësimi në garën e Evrovizionit. Vendi në të cilin zhvillohet vetëm një zgjedhje evropiane në të cilën marrin pjesë të gjithë njerëzit e Evropës është gara e këngës së Evrovizionit. Po të ishit pjesë e saj dhe po ta fitonit këtë garë, do të kishit bërë më shumë për imazhin e Kosovës dhe për ne që të kuptojmë se jemi pjesë e të njëjtës bashkësi evropiane, të njëjtës familje evropiane, sesa vetëm të pritnit për ditën x, y, z kur do të ndërmerrej hapi i radhës në procedurën diplomatike. Sërish them që agjenda politike, negociatat, raportet e progresit, etj., janë të detyrueshme, por mendoj se duhet të bëhemi shumë më kreativë, si në Kosovë ashtu edhe në BE, për ta ndihmuar integrimin e qytetarëve të Kosovës, posaçërisht atë të njerëzve të rinj, në të gjitha kontekstet e mundshme sociale të cilat i ndajmë së bashku, përfshirë këtu sportet, muzikën, arsimimin etj.

Blerta Deliu-Kodra – Ne, sapo jemi kthyer prej një vizite zyrtare në Irlandën Veriore, kemi qenë në qytetin London Dairy dhe kemi parë se sa ka investuar BE-ja për të shndërruar atë qytet me aktivitete të ndryshme kulturore.

Lüdger Kühnhard – U shpreh se në Irlandë për herë të parë kam qenë me prindërit e mi dhe imazhi im kryesor për Irlandën ka qenë i një shteti që në atë kohë nuk kishte gati fare vetura, por kishte qerre me kuaj ose me gomarë, nuk kishte rrymë elektrike të mirëfilltë, dhe e tëra kjo ka qenë para 40 vitesh, ndërsa pas krizës së fundit, e tërë Irlanda është shndërruar në njërin nga shoqëritë më të përparuara të Evropës, falë BE-së dhe unë jam plotësisht i vetëdijshëm për këtë mekanizëm. Për fat të keq, në shtetet më të mëdha të Evropës Qendrore, ne shpeshherë harrojmë se e tërë ideja për Evropën, që sillet rreth qendrës dhe periferisë së saj, është vetëm një fantazi në kokat tona. Varet se çka bëjmë ne me të gjitha resurset që i kemi në kontinent. Irlanda është një shembull i mirë se si nga Evropa mund të përfitojmë të gjithë ne. Sepse, konflikti është zgjidhur dhe shoqëria irlandeze është transformuar jashtë mase, gjatë kohës së vetëm të një gjenerate. Dhe këtë ia dëshiroj edhe Kosovës.

Lutfi Haziri – Tha se e falënderoj shumë profesorin, e falënderoj për pjesëmarrjen në takimin e Komisionit për Integritet Evropian dhe tha se do të jetë gjithmonë i mirëseardhur.

Ju faleminderit shumë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri